



Npi – 01/37 datë: 27.01.2023

KONKLUZION

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -I- të rregullt për vitin 2023, e mbajtur më 27.01.2023, pas shumë diskutimeve për pikën 12 (dymbëdhjetë) të rendit të ditës “Propozim-Vendim për ndryshimin e Vendimit Npi-01/54 për anëtarin e KPF-së” nuk e miratoi asnjë vendim, duke e lëshuar mbledhjen e Kuvendit, në ora 16:47h, anëtarët e subjektit politik të PDK-së, si vijon: Rrahman Jakupi, Përparim Ramusa, Lumni Amrush, Besartë Musliu-Spahija, Adem Ramadani, Hasan Avdyli, Hamëz Tërshani, Albana Podvorica, dhe Adelina Beqaj. Nga subjekti politik LB-ë Rexhep Gashi, dhe si anëtar i pavarur i Kuvendit, Reshat Mujota.

II

12. Propozim-Vendim për ndryshimin e Vendimit Npi-01/54 për anëtarin e KPF-së

Arsyetim:

z.Reshat Mujota; Unë e kam një propozim timin që në Komitetin për Politikë dhe Financa të shkojë z.Rexhep Gashi, në vendin e znj.Heroina Selmani e cila ditë më parë ka dhënë dorëheqje nga posti i anëtares të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Unë nuk do ta hedhë në votim propozimin e z.Reshat Mujota, për arsye se struktura ose përbërja e Komitetit nuk varet nga numri i votave por Ligji e përcakton përbërjen e Komiteteve të përhershme.

Në bazë të nenit 5 pikat 1, 2, dhe 3 të “Udhëzimit Administrativ të (MPL) Nr.05/2020 për Procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme e komiteteve tjera në Komunë” e përcakton në mënyrë të qartë se zëvendësimi në këtë rast i znj.Heroina Selmani duhet të bëhet nga anëtari i gjinisë së njëjtë dhe subjektit të njëjtë politik, e që ne e kemi propozuar znj.Zejnije Velion.

z.Përparim Ramusa; Rregullorja e thotë që ç’do propozim me e qitë në votim, nëse nuk e qitni në votim ne si subjekt politik i PDK-së e lëshojmë mbledhjen e Kuvendit.

z.Kadri Emini; Pikërisht për të njëjtën arsye në fillim na e kanë kthyer MAPL-ja vendimin e KPF-së për rishqyrtim. Unë edhe atëherë edhe tash po them se kjo nuk zgjidhet kështu, sepse partia në pushtet me shumicën e votave që i ka do të mund të zgjidhte të gjithë anëtarët e vet në të gjitha Komitetet.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Konstatoj Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje. Unë po e hedhë në votim propozimin që znj.Zejnije Veliu ta zëvendësojë znj.Heroina Selmanin në Komitetin për Politikë dhe Financa. Kush është “Për”.

Pas kësaj thirrje nga Kryesuesi për të votuar, 11 anëtarë të Kuvendit e lëshuan mbledhjen në ora 16:47h të përshkruar sikurse në pjesën e parë të këtij Konkluzioni.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Konstatoj se në sallën e kuvendit kanë mbetur 10 anëtarë, dhe nuk e kemi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen, prandaj mbledhjen po e përfundoj, meqenëse edhe nuk kemi pika të tjera të rendit të ditës, në ora 16:49h.

III

Konkluzioni u dërgohet: Arkivit, Drejtorisë, Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, dhe Zyres për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi